VENDIM
Nr.542, datë 29.12.1992

PËR DISA NDRYSHIME NË SISTEMIN E PAGESAVE

Me propozimin e Minnistrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dokumentete pagesave të lëshuara nga ndërmarrjet, si urdhërxhirimet, kërkesarkëtimet dhe çeqet, do të pranohen nga sistemi bankar vetëm nëse ka fonde të mjaftueshme në llogaritë e ndërmarrjes për të kryer pagesën.

2. Pas ballafaqimit të dokumenteve të pagesës me gjendjen e aftësisë paguese të ndërmarrjeve, nëse në lloagaritë që do të debitohen ka fonde të mjaftueshme, banka bën pagesën e menjëhershme.

Radha e likuidimit të detyrimeve përcaktohet nga vetë ndërmarrja, firma ose personi privat, të cilët janë disponuesit e vetëm të mjeteve që kanë në llogaritë e tyre bankare.

3. Banka duhet t'i kthejë mbrapsht ndërmarrjes, firmës ose personit privat urdhërxhirimet, kërkesarkëtimet ose çeqet, për të cilat nuk ka fonde të mjaftueshme në llogari, duke zbatuar ndaj tyre edhe një gjobë prej 5 për qind të shumës së dokumentit të prapësuar, por në çdo rast jo më tepër se 50 000 lekë.

4. Ankimi kundër vendimeve të marra në zbatim të pikës 3 të këtij vendimi, do të bëhet brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit të drejtori i bankës, vendimi i të cilit është i formës së prerë.

5. Duke filluar nga data 15 janar 1993, si mjete të sistemit të pagesave do të shërbejnë vetëm urdhërxhirimet dhe çeqet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi